



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 15 Prot.

Tiranë, më dt. 10.01.2018

VENDIM

Nr.12, dt. 10.01.2018

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 10.01.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “HEC Bregu i Madh Zaloshnje” Skrapar, me subjekt aplikues “HP ZALOSHINJA ENERGY” sh.p.k..
2. Shoqëria të kontribuojë për punime mirëmbajtje të objektit monument kulture: “Teqeja e Abaz Aliut”.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të **mbikëqyren** sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi

SEKRETARI KKR

Arta Dollani